

TRASHËGIMIA ETNOKULTURORE MBAHET TE VETË NJERËZIT

Nga Mimoza AHMETI

Studiuese, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Tradita mendohet si një sunduk i vjetër, një qilim nga koha e gjyshes që e ruajmë në shtëpi, si arkiva apo muzeume historike të qytetit. Në rastin më të mirë tradita mendohet si kujtesë kolektive. Por tradita për konceptin bashkëkohor nuk janë të gjitha këto, edhe pse mbeten pjesë të traditës. Gjuhë, lokalitete, mendësi dhe modele, vepronë mbi shtretërit breznorë që përcjellin qytetërim në mënyra të përpunuara traditore, të prodhimit dhe brendësimit psikologjik e shpirtëror të kushteve të dallueshme, që funksionojnë si kulturë, në të cilën mund të futen dhe ata që ndërkalen nëpër atë kulturë, të ardhur, të lindur apo edhe pasionantë kulturash.

Fjalë kyçe: tradita, lokalitet, kulture, qilim.

ABSTRACT

The tradition is thought of as an old chest, a rug from grandma's time that we keep at home, as archives or historical museums of the city. At best tradition is thought of as a collective memory. But the traditions for the contemporary concept are not all these, although they remain part of the tradition. Languages, localities, mentalities and models, act on the generational beds that convey civilization in traditional elaborate ways, of production and psychological and spiritual internalization of distinct conditions, which function as a culture, into which can enter and those who walk through it culture, newcomers, natives or even culture enthusiasts.

Key words: traditions, locality, culture, carpet.

HYRJE

Tradita mendohet si një sunduk i vjetër, një qilim nga koha e gjyshes që e ruajmë në shtëpi, si arkiva apo muzeume historike të qytetit. Në rastin më të mirë, tradita mendohet si kujtesë kolektive. Por, tradita për konceptin bashkëkohor nuk janë të gjitha këto, edhe pse mbeten pjesë të traditës. Tradita jeton te njerëzit. Ata mendojnë dhe vepronë sipas mënyrash të përthithura, në të cilat sigurisht një traditim ka lënë gjurmë. Por mund të mos jetë vetëm kaq. Gjuhë, lokalitete, mendësi dhe modele, vepronë mbi shtretërit breznorë që përcjellin qytetërim në mënyra të përpunuara traditore, të prodhimit dhe brendësimit psikologjik e shpirtëror të kushteve të dallueshme që funksionojnë si kulturë, në të cilën mund të futen dhe ata që ndërkalen nëpër atë kulturë, të ardhur, të lindur apo edhe pasionant kulturash.

TRASHËGIMIA ETNOKULTURORE MBAHET TE VETË NJERËZIT

Kultura dhe tradita shqipe provoi disa shkencetarë pasionantë europianë, një ndër të cilët e njoha personalisht, Robert Elsie, albanolog i shquar dhe kritik arti. Ai ishte më i mrekulluari ndaj trashëgimisë sonë, më tepër se cilido shqiptar dhe nuk e kuptova deri në fund ‘intrinsicun’ e lidhjes së tij shpirtërore me kulturën, gjuhën dhe vendin tonë si trashëgimi dhe gjendje. Ndoshta primitivja vitale dhe po aq autentike e shoqëruar me një hijeshi të pashoqe arti dhe kodimi në jetesë, veshje dhe komunikim, norma e kanune, një kulturë deri vonë orale, e oarrudhur gjatë nga shkrimi dhe legacia strikte e tij. Po ashtu, një nga poetet më me zë amerikanë, William Burroughs, kur pati kaluar nga Veriu i Shqipërisë kishte ndër të ndierë, ndërsa shkonte

tutje, një muzikë filogenetike, sikurse e quante ai. Pra, kulturat janë të hapura për bartës apo pëlqyes edhe jashtë tyre dhe mbeten të tërheqëse jo vetëm për bartësit e tyre natyrorë, nëse kemi tashmë të tillë. Pikërisht kjo ngjarje është tregues se kulturat dhe trashëgimitë janë të hapura dhe të dëshiruara për bartës, sepse pa ta ato janë të vdekura. Sa më shumë bartës, aq më i madh është dimensionin social i një kulture. Përfundimi është se trashëgimia botërore, me gjithë dallimet lokale, nuk është më pasuri e një lloji, kombi apo race, sikurse dhe nuk ka qenë, por është një evidencë përdorimi për gjithë njerëzimin, pavarësisht se funksionon në mënyrë sociale dhe te kondensuar në një lokalitet apo rajon të caktuar.

Ky moment që shkëput bartasin natyral të kulturës nga posedimi i përkatësisë absolute dhe krenarisë mbi të, pasi siç edhe e provuam, shqiptar mund të jetë edhe një anglez, kanadez apo siç mund të jetë anglez, amerikan apo gjerman edhe një shqiptar. Këtu krenaria legjitime e identitetit i le vend legjitimitet të zgjedhjes së identitetit dhe ky është çelësi i fuzionit të kulturave dhe rritjes së ‘bonsensit’ nëpërmjet shtegëtimit, dmth përjetimit dhe shijimit të tjetrit kulturor si vete, virtualisht me simbole e lexime apo prezent në vendin e ngjarjes traditore. Forma brendësuese e globalizmit linguistik, por jo si forcë, por si parapëlqim, si nevojë për të vazhduar në gjuhë, në një gjuhë tjetër, në një kulturë tjetër, siguron dhe ka siguruar historikisht komunikimin. Përtej njeriut, pra, nuk mund të flasim për traditë. Mund të flasim për artefakte të traditave. Por, dhe ato nuk janë të gjitha njësoj!?. Sepse asgjë nuk është njësoj. Dhe çdo përgjithësim ‘intersekon’ në përgjithësim të kulturave fqinje, kryesisht.

Traditat ndryshohen, përpunohen, përshtaten. Këto ndërrime shihen edhe në stilin e jetesës por edhe në punët e dorës, fabrikimet e trashëguara artizanale si biznese, gatimet, verërat, ndërtimet dhe lloji i të folmeve deri te veshjet. Në menyrat gjithashtu sesi migrimet fuzojnë në kultura, pëqasen format e reja të mendësive, shprehjes dhe brendimit gjuhësor. Njerëzit janë burime dhe variojnë duke krijuar botë me shumë shenja, kusht ky për një pasuri të madhe nuancore kuptimore mbi të njëjtin objekt. Këto shumëllojshmëri relativizojnë ‘definicionet’ dhe krijojnë procesim, dmth vijim, por dhe përplasje, pra, konflikt. Mos harrojmë atë që thotë Gustav Mahler, se tradita është përcjellja e zjarrit dhe jo kujtesa e hirit. Toleranca e të kuptuarit të aksesit kulturor që të krijon ‘komfort’ dhe marrëdhënie për vetëpërtëritje në shoqëritë e hapura nuk është një ‘ekskluzivitet’ vetëm për ty apo grupin përkatësor, por kjo nuk mohon përkushtimin dhe pjesëmarrjen tënde në një apo disa kultura njëherësh, prej gjuhësh, funksionesh, prezencë, etj., si edhe nevojën që vetë ato, kulturat, të ruajnë një nivel homogjeniteti pa e riskuar komunikimin.

Flitet sot për një rinovim kulturor, për një rikrijim të kulturës dhe njeriut nëpërmjet traditës, për një rifreskim nëpërmjet instrumentalizimit të trashëgimisë kulturore dhe kombit. Dhe kjo po ndodh. Ndoshta jo thjesht si nevojë politike, por edhe matjeje e ridimensionim të vlerës tradicionale në fushën globale. E vërteta është se për të mbajtur kulturat gjallë ka dalë në qendër nevoja për njeriun. Lëvizja e këtij koncepti nga kultura si term abstrakt te mbartësi si term konkret, pra te njeriu, krijon një seri ‘implikimesh’ që janë objekt i shkencave, por edhe subjekt i politikës, të cilat e bëjnë shumë komplekse dhe po aq ‘ambiguous’ çështjen e traditës, duke amulluar në mënyrën më të mirë herë herë konturet radikale mes kulturave, gjuhëve dhe trashëgimive, për të ulur tonet e krenarisë identitare dhe hapur rrugën e bashkërendimit. Helvetius, gjeniu skandaloz i kohës së revolucionit francez, thoshte se identiteti është vetëm një piket te njeriu. Ai nuk e ‘ezauron’ atë. Ndërsa vetë njeriu, sidomos sot, mund të jetë multi identitar – dimensional - gjuhësor.